



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Punimje/Produkti Receiver/Delivry	19. 07 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shifra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTK	4498/2022		1/5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.664/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Kocanëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2084/21, të datës 20.06.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.664/2021 të datës 16.07.2021 e parashtruar nga ankuesi

me adresë

në çështjen juridike

“Kompensim Material”, kundër organit të punësimit Komunes së Prizrenit, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 18.07.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET** poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.664/2021 e datës 16.07.2021 e parashtruar nga ankuesi

Arsyetim

Kryetari i Komunes së Prizrenit, me datë 16.01.2020 ka nxjerr Aktvendim me Nr.01-118-6358 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për ankuesin, duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesi me datë 07.02.2020 me numër 01-120-16774 ka parashtruar kërkesë tek Komuna e Prizrenit zyra e personelit me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të tij duhet ti bëjë pagesën e tri (3) pagave, pas arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa më datë 13.02.2020 Asistentja administrative në Komunën e Prizrenit e ka njoftuar ankuesin se Ministria e Financave nuk pranon të realizojë pagesat tjera përveç me rastin e arritjes së moshës së pensionimit i lejohet kompensimi i një pagese në shumën e një (1) page mujore të njehershme në vlerën e pagës së fundit.



Ndërsa pakënaqur me vendimin me numër 01-118-6358, të datës 16.01.2020 të Kryetari të Komunës së Prizrenit, me datë 14.07.2021 përmasë postës parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të tij duhet ti bëjë pagesën e tri (3) pagave, pas arritjes së moshës së pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.07.2021, me numër protokoll 3987/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa me datë 23.06.2022, me numër protokoll 3657/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prizrenit, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, me shkresën me numër protokoll 4414/2021 të datës 26.08.2021 ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 20.06.2022 ka nxjerr Aktgjykimin Anr.2084/21 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtojë dhe të vendos për ankesën A.nr. 664/2021 e datës 16.07.2021 të parashtruar nga ankuesi

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 3775/2021 të datës 16.07.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.2084/21 i datës 20.06.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i pranuar në KPMSCHK më datë 22.06.2022; Fletëkthesë e datës 04.08.2021; Fletëkthesë e datës 01.09.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 29.07.2021; Njoftim i datës 26.08.2021; Plotësim i Padisë së paditësit B.K. e datës 08.06.2021; Aktvendim për përfundimin e marrëdhënies së punës me numër 01-118-6358 i datës 16.01.2020; Vërtetim me nr. 02-113-9878/01 i datës 23.01.2020; Letërnjoftim i B.K.; Lista e pagave; Fletëparaqitja e të dhënave mbi përcaktimin e të ardhurave personale dhe stazhin e sigurimit e B.K. i datës 31.01.2020; Libreza e punës me numër 85370; Shënimet të përgatitjes shkollore e profesionale e B.K.; Shënime të inkuadrimit në punë ½ faqe; Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1951/20 i datës 14.06.2021; Vërtetim për përvojën e punës i datës 31.01.2020; Përgjigje në kërkesë e datës 13.02.2020; Shkresë nga Raiffeisen Bank e datës 13.02.2020; Vendim i datës 03.02.2020; Padi e paditësit B.K. e datës 18.02.2020; Pliko me nr. R1644165 e datës 14.07.2021; e-mail nga I.G. për C.Z. i datës 23.06.2022; e-mail nga C.Z. për I.G. i datës 23.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 23.06.2022; Kërkesë me nr.02-120-16774 e datës 07.02.2020; e-mail nga I.G. për C.Z. i datës 24.06.2022; Pagesa shtesë me rastin e pensionimit e datës 01.04.2020 deri 30.04.2020; e-mail nga I.G. për C.Z. i datës 29.06.2022; e-mail nga C.Z. për I.G. i datës 29.06.2022; Akt Emërimi i B.K. i datës 04.01.2012; Kontrata e Punës me nr.01-112-431 e B.K. e datës 04.10.2004; Përshkrimi i vendit të punës; e-mail nga I.G. për C.Z. i datës 13.07.2022; e-mail nga C.Z. për I.G. i datës 12.07.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa lejuar sepse:



Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në kohën kur ankuesi është pensionuar sipas Aktvendimit me Nr.01-118-6358 të datës 16.01.2020 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, ka qenë iu zbatueshëm Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa në bazë të Aktvendimit me Nr.01-118-6358 të datës 16.01.2020 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, palës së pakënaqur i është dhënë këshilla juridike të mund të parashtrojë ankesë brenda 30 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Meqenëse në këtë periudhë kohore që qenë i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i njëjti ka përcaktuar organet të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil, konkretisht neni 81 paragrafi 2 i këtij ligji, ka përcaktuar se: *"Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës"*, ndërlidhur me këtë neni 50 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nëpunësit civil kanë të drejtë mbrojtje përmes procedurave të brendshëm administrative ose gjyqësor, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar që ankuesi kundër Aktvendimit me Nr.01-118-6358 të datës 16.01.2020 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, është dashur të parashtrojë ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit ashtu siç përcaktohet në nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës"*, pastaj në rast të pakënaqësisë me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke u bazuar në nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative ka mundur të ushtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në dispozitat e nenit 16 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit..."* dhe nenit 3 paragrafit 6 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, ankuesi duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit..."*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesë e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura dhe si e tillë është e paraafatshme.


Theksuar si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.664/2021

Çlirim ZEKA

  
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Znj. *Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative*
- Udhëheqësitë të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

